



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 384/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Ymer Hoxha dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Shtime paraqitur kundër Partisë Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Shtime, për shkak të parregullsive gjatë mbajtjes së tubimit zgjedhor në vend publik, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 01.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV)

Arsyetim

Me datën 29.10.2013, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se Partia Demokratike e Kosovës (PDK) më datë 28.10.2013 në orën 15:46 në Shtime kanë fotografuar daljen e nxënësve nga shkolla fillore “Naim Frasheri” të cilët kishin kryer orarin e rregullt të mësimit për shkak të tubimit i cili do të duhej të mbahej nga subjekti politik PDK. Me këtë rast sipas parashtruesit të ankesës është bërë pengimi i mbarëvajtjes së mësimit në shkolla publike me këto veprime janë bërë shkelje të nenit 4.1 i Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur pesë fotografi si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PDK, me datën 30.11.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 31.10.2013 deri në ora 12:00. PZAP-i në afatin e paraparë pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK, lidhur me ankesën A.nr 384/2, të paraqitur nga subjekti politik LVV, ku theksohet se PDK konsideron si të pa baza pretendimet e LVV-së dhe se sipas të dhënave që posedojnë tubimi i caktuar ka qenë i paralajmëruar dhe i lejuar sipas të gjitha rregullave të zgjedhjeve me këtë rast nuk është penguar procesi i rregullt mësimor.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Subjekti politik LVV, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se Partia Demokratike e Kosovës (PDK) më datë 28.10.2013 në orën 15:46 në Shtime kanë fotografuar daljen e nxënësve nga shkolla fillore "Naim Frasheri" të cilët kishin kryer orarin e rregullt të mësimit për shkak të tubimit i cili do të duhej të mbahej nga subjekti politik PDK. Me këtë rast sipas parashtruesit të ankesës është bërë pengimi i mbarëvajtjes së mësimit në shkolla publike me këto veprime janë bërë shkelje të nenit 4.1 i Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Një pretendim i tillë i ankesës u vlerësua si i pabazë dhe i pa argumentuara në prova dhe në dëshmi bindëse për shkeljen e pretenduar, sepse nga fotot e ofruara shihen nxënësit në rrugë, mirëpo shihet qartë dhe se nuk mund të identifikohet vendi i ngjarjes. Kështu që nuk mund të konstatohet se është bërë shkelja e supozuar, prandaj duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 384/2013 më datën 01.11.2013.

Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*